



Pranimi / Dërgimi Prilaz / Pristup Receipt / Delivery	13-05-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Odzina Org / Unit	Nr. Prot Prilaz Prot No	Shtjepa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHK	2790/2022		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.318/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca – kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.318/2022 të datës 01.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit Nr.13-112/12-0018976/22 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.318/2022 të datës 01.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja më datë 01.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1786/2022, e regjistruar me shenjë A.nr.318/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.13-112/12-0018976/22 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës, ndërsa kjo fundit më datë 19.04.2022, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesa me numër protokoll 1786/2022 të regjistruar me shenjë A.nr.318/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 22.11.2021; Listën e aplikantëve; Njoftimin e

datës 24.12.2021 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 25.02.2022; Njoftimin e datës 02.03.2022; Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Rezultatit e vlerësimit të datës 07.03.2022; Rezultatit pas afatit të ankesave të datës 15.03.2022; Vendimin e datës 11.02.2022 për themelimin e komisionit; Aplikacioni i ankueses me dokumentacionin e bashkangjitur për përgatitjen profesionale, përvojën e punës dhe certifikatat e trajnimeve; Aplikacionin e kandidatit me dokumentacionin e bashkangjitur për përgatitjen profesionale, përvojën e punës dhe certifikatat e trajnimeve; Ankesa e ankueses e datës 08.03.2022 për Komisionin e Pranimit në Këshillin Komunal të Podujevës; Vendimin e datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankueses

#### **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Komuna e Podujevës, më datë 01.11.2021 ka shpallur Konkursin e hapur me numër reference RN00007792 për pozitën e punës *Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore/ Zyrtar i Trashëgimisë, klasa profesional - 2*. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 22.11.2021 deri me 06.12.2021. Në këtë konkurs kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesen. Në listën e ngushtë të datës 14.12.2021 janë përfshirë katër (4) kandidatë, në kuadër të cilës është edhe ankuesja e cili ka qenë edhe pjesë e të gjitha fazave tjera të konkurrimit, respektivisht në testimin me shkrim i mbajtur më datë 01.03.2022 dhe intervistën me gojë të mbajtur më datë 04.03.2022. Sipas Listës përfundimtare të Komisionit të Pranimit i themeluar sipas Vendimit me Nr.02-020/04-0010235/22 të datës 11.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevas, kandidati me i vlerësuar duke u renditur i pari në listë është Ramiz Kodraliu me gjithsej 80.6 pikë, ndërsa ankuesja është vlerësuar si kandidatja e tretë me gjithsej 51 pikë. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës, më datë 07.03.2022 ka bërë publikimin e njoftimit për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesja e pakënaqur me Njoftimin e datës 07.03.2022, më datë 08.03.2022 parashtron ankesë pranë Komisionit të Pranimit i cili me Vendimin Nr.13-112/12-0018976/22 të datës 14.03.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses dhe rrjedhimisht ka lënë në fuqi njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 07.03.2022.

Ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë duke kundërshtuar Vendimin Nr.13-112/12-0018976/22 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit, me pretendimet ankimore se ka pas shkelje ligjore lidhur me procedurën rekrutuese për pozitën e punës *Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore/Zyrtar i Trashëgimisë*, që nga faza e verifikimit të aplikacioneve e deri të shpallja e rezultatit përfundimtar si dhe e kundërshton përzgjedhjen e kandidatit fitues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesja si kandidate në Konkursin me numër reference RN00007792 për pozitën e punës *Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore/ Zyrtar i Trashëgimisë*, me datë 01.04.2022 ka pashtuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Njoftimit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës të datës 07.03.2022, me pretendimet ankimore se gjatë vlerësimit në këtë procedurë të konkurrimit janë bërë shkelje të dispozitave thelbësore ligjore në vlerësimin e datës 07.03.2022, verifikimin paraprak si dhe vlerësimin e jetëshkrimit/CV, resumesë dhe testimit.



Kolegji, me rastin e shqyrtimit të provave materiale ka konstatuar se edhe kandidati si kandidat në këtë procedurë të rekrutimit, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1910/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku Kolegji i Këshillit me Vendimin A.nr.339/2022 të datës 10.05.2022 ka aprovuar ankesën dhe rrjedhimisht ka anuluar procedurën e rekrutimit me numër reference RN00007792 për pozitën e punës *Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore/Zyrtar i Trashëgimisë*. Andaj, mbi këto arsye, e në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, Kolegji ka konstatuar se janë përmbush kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën A.nr.318/2022 të datës 01.04.2022, pasi që objekti i ankesës është bërë i pamundur apo i kotë.

Nga sa u tha si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.318/2022

Valentina Kaçadolli Bekteshi  
*Procesmbajtëse*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

